



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Histori**

Lënda: BURIME MESJETARE PËR HISTORINË E SHQIPËRISË

<i>Pedagogu:</i>	Ph.D.c. Andi REMBECI
<i>Ngarkesa:</i>	4 ETCS (30 leksione dhe 15 seminare (totali në auditor 45 orë, jashtë auditorit 65 orë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	Me zgjedhje
<i>Viti/Semestri:</i>	II/I

Përshkrimi: Për gati dhjetë shekuj me radhë tokat shqiptare, rrjedhimisht edhe populli shqiptar ishin nën zotërimin e Perandorisë Bizantine. Gjatë shekujve mesjetarë bizantinë u shënuua lindja dhe zhvillimi i marrëdhënieve feudale dhe i ndryshimeve të mëdha ekonomike-shoqërore në hapësirat shqiptare. Gjithashtu, gjatë periudhës mesjetare bizantine mori udhë procesi i formimit dhe i konsolidimit të kombësisë shqiptare me karakteristikat dhe elementët e saj që e veçonin ndërmjet kombësive të tjera në Ballkan. Në Perandorinë Bizantine shqiptarët ishin pjesë aktive e proceseve të mëdha ekonomike shoqërore dhe e ngjarjeve politike, duke afirmuar fizionominë e vet kulturore dhe politike. Populli shqiptar, pjesë e një Perandorie të madhe e të fuqishme, që shtrihej për një periudhë në të tre kontinentet e njohura në atë kohë, arriti të ruaj vetitë e tij thelbësore, por sakaq u ndikua fuqishëm prej saj, duke na lënë si gjurmë edhe sot një trashëgimi të pasur kulturore.

Kjo periudhë e rëndësishme e jetës dhe e veprimtarisë së popullit shqiptar gjen pasqyrim edhe në burimet e kohës. Krahas burimeve të shkruara perëndimore, vendin kryesor e zënë ato mesjetare bizantine dhe kjo është e natyrshme për arsye të sundimit të gjatë të kësaj perandorie në trevat shqiptare. Burimet mesjetare bizantine zënë një vend qendror, pa të cilat nuk mund të ndërtohet pjesa më e madhe e historisë mesjetare të Shqipërisë, pra nuk mund të pasqyrohet vazhdimësia e evolucionit të popullit shqiptar gjatë historisë së tyre mijërvjeçare.

Burimet historike mesjetare bizantine, që përmbajnë njoftime mbi trevat shqiptare dhe shqiptarët, janë të shumëllojshme: histori politike dhe kishtarë, kronika, dokumente dhe akte zyrtare të perandorëve, institucioneve shtetërore dhe kishtarë, fjalime e ligjërata politike, monumente ligjore, manuale ushtarake, jetëshkrime shenjtorësh etj. Të gjitha këto mund të ndahen në dy grupe të mëdha sipas karakterit të tyre: në burime tregimtare dhe në burime dokumentare.

Hapat e trajtimit të këtyre burimeve mesjetare në kuadrin e kësaj lënde do të përfshihen në dy pjesë: a) elementë të formës së burimeve mesjetare dhe, b) katalogu i burimeve mesjetare bizantine në renditje kronologjike. Në pjesën e elementëve të formës do të trajtohet çështje që lidhen me: natyrën dhe llojet e burimeve mesjetare bizantine, autorët dhe shënime biografike të tyre, veçantinë e burimeve sipas periudhave historike, dokumentet bizantine si burime për historinë e mesjetës shqiptare. Në pjesën e dytë, studentët do të prezantohen me tekste të përzgjedhura nga burimet mesjetare bizantine që flasim për historinë e mesjetës shqiptare, duke u aftësuar njëkohësisht në kuptimin, interpretimin dhe komentimin e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



TEMAT:

1. Kuptimi i termit “burime” – Kategorizimi i burimeve mesjetare bizantine.
2. Hyrje në kategoritë e veçanta të burimeve mesjetare dhe bizantine.
3. Autorët e burimeve mesjetare bizantine dhe të dhëna biografike I.
4. Autorët e burimeve mesjetare bizantine dhe të dhëna biografike II.
5. Burime mesjetare bizantine për shek. IV.
6. Burime mesjetare bizantine për shek. V.
7. Burime mesjetare bizantine për shek. VI.
8. Burime mesjetare bizantine për shek. VII.
9. Burime mesjetare bizantine për shek. VIII.
10. Burime mesjetare bizantine për shek. IX.
11. Burime mesjetare bizantine për shek. X.
12. Burime mesjetare bizantine për shek. XI.
13. Burime mesjetare bizantine për shek. XII.
14. Burime mesjetare bizantine për shek. XIII.
15. Burime mesjetare bizantine për shek. XIV.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI: 70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 5-10 faqe (format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

Literatura e detyrueshme për studentin:

Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, II, (shek. VIII-XV), bot. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësive, 1962.

Koço Bozhori, Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, shek. X-XV, Tiranë 1975.

Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Historisë, vëll. I, bot. Toena, Tiranë 2002 (Pjesa e dytë – Mesjeta)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



Literatura plotësuese:

Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia. Vol. II, Annos 1344-1406 continens / collegerunt et digesserunt Dr. Ludovicus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček et Dr. Emilianus de Sufflay

J. Vaentini (Ed.), *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*, vol.I-XXV, Palermo – Milano – München – Roma, 1967-1977.

Ilirët dhe Iliria te autorët antikë (shek. IV-VII), bot. Universiteti Shtetëror, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë 1965.

Koço Bozhori, *Lufta Shqiptaro-Turke në shek. XV. Burime bizantine*, Tiranë 1967.

Aleks Buda, *Shënime historike*, vëll. I-II, Tiranë 1986.

Aleksandër Meksi, “Të dhëna për historinë e hershme mesjetare të Shqipërisë (fundi i shek. VI – fillimi i shek. IX)”, *Iliria* 1 (1989).

Andi Rembeci, Sokol Cunga, *Dorëshkrime Bizantine dhe Pاسبizantine në Shqipëri*, Katalog shkencor, bot. FGK-Vatra Tiranë, Tiranë 2010.

Andi Rembeci, «Botime të mbishkrimeve kishtarë bizantine në Shqipëri», *Kërkim* 6-7 (shtator-dhjetor 2010 – janar-prill 2011), fq. 134-156 dhe 129-142.

Andi Rembeci., «The codex of the Metropolis of Korça and Selasforus as a Historical Source», *Albanohellenica* 4 (2011), fq. 97-112.

Eqerem Çabej, “Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve”, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës – Seria e Shkencave Shoqërore* 2 (1958).

Georg Ostrogorsky, *Historia e Perandorisë Bizantine*, bot. Dituria, Tiranë 2007.

Koço Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes së emërtimeve Arbanon në kohën bizantine”, *Studime Historike* 4 (1972).

Pëllumb Xhufi, “Shqiptarët dhe Anzhuinët”, *Studime Historike* 2 (1986).

Pëllumb Xhufi, “Shteti i Arbërit”, *Shkenca dhe jeta* 1 (1991).

Pëllumb Xhufi, “Skurrajt e Arbërit”, *Studime Historike* 2 (1991).

Pëllumb Xhufi, *Dilema e Arbërit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*, bot. Pegi, Tiranë 2006.

Pëllumb Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt. Berati dhe Vlora në shekujt XII-XV*, bot. 55, Tiranë 2009.

Spiro Shkurti, “Vendbanimet fshatare dhe ekonomia bujqësore në Shqipërinë mesjetare”, *Etnografia Shqiptare* 17 (1997).

The Medieval Albanians, International Symposium 5, National Hellenic Research Foundation – Institute for Byzantine Research, Athens 1998.